



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja c), dhe nenit 40, paragrafi 40.2, shkronja a) e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/04 qershor 2008), nenit 15, shkronja f) të Ligjit nr. 03/L-049, për financat e pushtetit lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 27/03, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja c) e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, e dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 01.08.2019, e miratoi këtë

RREGULLORE

**PËR ORGANIZIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E PARKINGJEVE TË KOMUNËS
SË PRISHTINËS**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i zonave të vendparkimeve, kushteve për shfrytëzimin e vendparkimeve, mënyrës së pagesës, çmimit dhe llojit të biletave për vendparkim, mënyrës së shfrytëzimit të tyre dhe mbikëqyrjes për parkimin e veturave në territorin e komunës së Prishtinës.

Neni 2

Hapësira publike e parkimit, është hapësirë e dedikuar për parkimin e veturave, e cila është e rregulluar si vendparkim dhe i shënjuar me shenja të komunikacionit dhe me informata rreth zonës së parkimit, me çmimet varësisht nga koha e parkimit, si dhe mënyrën e pagesës së parkimit.

II. LLOJET E PARKINGJEVE

Neni 3

Llojet e parkingjeve në kuptim të kësaj rregulloreje, konsiderohen:

1. Vendparkimet publike, me kohë të caktuar;

- 1.1.Vendparkimet përgjatë rrugëve publike dhe hapësirave të destinuara si vendparkime publike,
- 1.2.Vendparkimet “Parko dhe udhëto” (Park&Ride),
- 2. Vendparkimet me PPP – garazhet;
- 3. Parkingjet private.

Neni 4

1. Vendparkime publike, janë të gjitha vendparkimet përgjatë rrugëve publike dhe hapësirave të destinuara si vendparkime publike, që menaxhohen nga Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking.
 - 1.1 Hapësirat e vendparkimeve publike, me vendim të veçantë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, mund t’u jepen në shfrytëzim institucioneve vendore, ndërkombëtare dhe diplomatike;
 - 1.2 Vendparkimet si në pikën 1.1 paguhen në Ndërmarrjen Publike Lokale Prishtina Parking, sipas çmimoreve të përcaktuara.
2. Vendparkimet me PPP – garazhet nëntokësore, menaxhohen nga operatori privat, i përzgjedhur përmes procedurave të prokurimit.
3. Vendparkime private, janë të gjitha ato vendparkime të cilat i përmbushin standardet dhe vendimin nga Drejtoria e Urbanizmit, si vijon:
 - 3.1.Të ketë shenjëzimin horizontal dhe vertikal;
 - 3.2.Kyçja të mos lejohet në rrugën e cila ka më tepër se dy shirita për kahje të njëjtë të lëvizjes;
 - 3.3.Parkingu duhet të ketë qasje direkte në rrugë, jo të kalojë përmes trotuarit.
 - 3.4.Shtrimin me kubze betoni, asfalt;
 - 3.5.Të ketë sistemin e kamerave;
 - 3.6.Lokacioni të jetë hapësirë parkimi sipas planit urban;
 - 3.7.Hapësira për vendparkim të ketë së paku 20 vendparkime;
 - 3.8. Hapësira e parkimit mund të lejohet edhe në destinime të tjera, e cila ka karakter të përkohshëm, por që nuk pengon realizimin e planit rregullues dhe të jetë sipas kriterëve të caktuara në këtë nen. Përzullimi i vendimit në pikën 3.8 bëhet nëse kërkohet realizimi i Planit rregullues para afatit të dhënë në leje.
 - 3.9.Dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e pëlqimit për kyçje dhe të hapësirës së vendparkimit:
 - 3.10. Origjinali i kopjes së planit dhe certifikata e pronësisë jo më e vjetër se 6 muaj, apo kontratë e noterizuar për shfrytëzimin e hapësirës;
 - 3.11. Projektin për kyçje dhe funksionet e hapësirës së vendparkimit, i hartuar nga inxhinieri i komunikacionit rrugor;
 - 3.12. Certifikatën e biznesit për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse;
4. Lejen për ushtrimin e veprimtarisë afariste të parkingjeve e jep Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, pas plotësimit të kriterëve të parapara sipas nenit 4, paragrafi 3;

5. Në momentin e pajisjes me leje si në nenin 4, paragrafi 4, operatori obligohet të pjjiset me arkë fiskale.
 - 5.1.Kuponi fiskal duhet të lëshohet në momentin e fillimit të kohës së parkimit.
 - 5.2.Kuponi i lëshuar duhet të vendoset në pjesë të dukshme në xhamin e përparmë të automjetit të parkuar.
6. Taksa vjetore për dhënien e lejes si në nenin 4, paragrafi 4, do të jetë:
 - 6.1.ZONA I (Qendra e qytetit) – 500 €;
 - 6.2.ZONA II - Hapësira që përfshihet nga unaza qendër deri tek unaza e brendshme e qytetit – 300 €;
 - 6.3.ZONA III – Hapësira jashtë unazës së brendshme – 200 €.

7. Vendparkimet publike që menaxhohen nga operatori:

1. Vendparkimet publike me pagesë për banorët rezidentë;
2. Vendparkingjet publike mund të jenë të përhershme ose të përkohshme, rrugore dhe jashtërrugore;
3. Vendparkingjet e përhershme publike janë ato, në të cilat parkimi paguhet gjatë tërë vitit kalendarik;
4. Vendparkimet e përkohshme publike janë ato, në të cilat parkimi paguhet gjatë rregullimit të përkohshëm të komunikacionit, gjatë organizimit të manifestimeve të ndryshme, ngjarjeve dhe të ngjashme;
5. Vendparkimet rrugore publike janë parkingjet të cilat gjenden në rrugë dhe trotuare, të shënuara në mënyrë të vëçantë me shenja horizontale dhe vertikale, në pajtim me Ligjin e sigurisë në komunikacion dhe me dokumentacionin teknik;
6. Vendparkimet jashtërrugore publike janë ato të cilat gjenden jashtë rrugës dhe janë të shënuara me shenjat vertikale dhe horizontale, në pajtim me këtë vendim, dhe janë të përcaktuara në hapësirë me projekt të veçantë.
7. Vendparkimet jashtërrugore publike mund të jenë të asfaltuara ose me kubze betoni.

8. Venparkimet “Parko dhe udhëto” (Park & Ride):

1. Venparkimet “Parko dhe udhëto” (Park & Ride), janë parkimet e lokalizuara në distanca më të mëdha larg qendrës së qytetit, janë të lidhura me një shërbim tërheqës të transportit publik me qendrën kryesore urbane. Sigurimi i hapësirave të parkimit në periferi të qytetit, ka për qëllim të ndërpresë trafikun e udhëtarëve, të turistëve dhe banorëve, dhe t'i transportojë ata në qendër të qytetit përmes lidhjes së shpejtë dhe të shpeshtë, me cilësi të lartë të transportit publik. Kjo do të zvogëlojë nivelin e mbingarkesës në qendër të qytetit dhe do të mundësojë rialokim të hapësirës për qëllime të tjera;
2. Lokacioni i vendparkimeve “Parko dhe udhëto” duhet të jetë i pozicionuar mirë, të arrihet lehtësisht dhe të jetë i dukshëm ose i shenjuar mirë nga anët e rrugëve kryesore për qasje;
3. Kostoja e përdorimit të shërbimit duhet të jetë shumë më e vogël sesa parkimi në parkingjet e zonës qendrore të qëndrimit afatgjatë;

4. Lokacioni duhet të ofrojë elemente përcjellëse të mira, si strehim, telefona, siguri, ndriçim dhe dukshmëri të mirë.
5. Gjatë shqyrtimit të sistemit “Parko dhe udhëto”, ekzistojnë një numër çështjesh specifike, që duhet të adresohen në vlerësimin dhe zhvillimin e skemës për Prishtinën, duke përfshirë:
 - 5.1. Mundësinë e lokacioneve të ndryshme në pajtim me politikat;
 - 5.2. Vendndodhjen dhe dizajnin e hapësirave;
 - 5.3. Klientelën, ofrimin e mënyrave tjera të lëvizjes dhe kapacitetin për biznes;
 - 5.4. Lidhshmërinë me vendparkimet në dispozicion në zonën qendrore të qytetit dhe kostos së parkimit në zonën qendrore;
 - 5.5. Lidhshmërinë me propozimet e tjera brenda Prishtinës, duke përfshirë zhvillimin e itinerareve të linjave kryesore dhe dytësore të autobusëve.

Neni 5

MENAXHIMI DHE KLASIFIKIMI I VENDPARKIMEVE PUBLIKE

1. **Vendparkimet e kaltërta**, të shënuara me një vijë ngjyrë të kaltër (sinjalizimi vertikal dhe horizontal), është e përcaktuar për banorët. Vetëm banorët me leje të vlefshme parkimi, të cilët parapaguajnë, mund të parkohen në vendparkimet e kaltërta. Të tjerët mund t’i përdorin këto vendparkime vetëm pasi të kenë paguar përmes aplikacionit online të parkimit ose duke përdorur aparatën e biletave të parkimit. Kjo mënyrë e përdorimit të vendparkimeve lejon një kohë maksimale të parkimit prej 2 orësh.
2. **Vendparkimet vjollce**, të shënuara me një vijë ngjyrë vjollce (sinjalizimi vertikal dhe horizontal), është e përcaktuar për banorët. Vetëm banorët me leje të vlefshme parkimi të cilët parapaguajnë mund të parkohen në vendparkimet vjollce. Të tjerët mund t’i përdorin këto vendparkime më së shumti për 24 orë, vetëm pasi të kenë paguar përmes aplikacionit online të parkimit ose duke përdorur aparatën e biletave të parkimit.
3. **Vendparkimet e portokallta**, të shënuara me një vijë të bardhë të ndërprerë dhe një shenjë trafiku me një shirit ngjyrë portokalli, janë përcaktuar për të ashtuquajturin parkim me kohë të shkurtër. Të gjithë përdoruesit mund t’i përdorin vendparkimet e portokallta për parkim më së shumti deri në 2 orë dhe vetëm pasi të kenë paguar përmes aplikacionit online të parkimit ose duke përdorur aparatën e biletave të parkimit.
4. Biletat e parkimit mund të paguhën duke përdorur aparatën e biletave të parkimit (pagesë me anë të kartelës ose parave të gatshme - Euro), ose duke përdorur aplikacionin online të parkimit. Klientët do të identifikohen duke përdorur numrin e targave të automjeteve të tyre. Inspektimi i lejeve të parkimit do të bëhet në mënyrë automatike, duke përdorur një sistem monitorues.

Neni 6

ZONAT E PARKINGJEVE

Vendparkingjet publike klasifikohen në zona:

1. ZONA I (Qendra e qytetit), klasifikohet si zona më e shtrenjtë, me kohëzgjatjen më të shkurtër të lejuar të parkimit. Hapësira që përfshihet brenda unazës qendër.

2.ZONA II - Hapësira që përfshihet nga unaza qendër deri tek unaza e brendshme e qytetit;

3.ZONA III – Hapësira jashtë unazës së brendshme.

4.Rrugët e unazës qendër dhe unazës së brendshme janë të definuara me dokumente të Planifikimit hapësinor.

III. SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL

Neni 7

1. Parkingjet janë sipërfaqe për parkimin e automjeteve, të cilat përbëhen nga një apo më shumë vende të parkimit. Vendi për parkim është vendi i përcaktuar për parkimin e automjeteve. Mund të jetë i vendosur në parkingje të rregulluara, në rrugë apo në garazhe. Detyra e vendparkimit të shënuar është vendosja e automjeteve në hapësirë, në njërin nga mënyrat e organizimit të parkimit me dimensionet përkatëse:
 - 1.1.Vendparkimi në 90° - 250cm X 455cm, gjerësia e kalimit 550cm, për lëvizje një ose dykahore;
 - 1.2.Vendparkimi në 60° - 250cm X 485cm, gjerësia e kalimit 470cm për lëvizje njëkahore dhe 550cm për lëvizje dykahore;
 - 1.3.Vendparkimi në 45° - 250cm X 485cm, gjerësia e kalimit 350cm për lëvizje njëkahore dhe 550cm për lëvizje dykahore;
 - 1.4.Vendparkimi në 30° - 250cm X 425cm, gjerësia e kalimit 350cm për lëvizje njëkahore dhe 550cm për lëvizje dykahore;
 - 1.5.Vendparkimi në 0° - 215cm X 640cm, gjerësia e kalimit 350cm për lëvizje njëkahore dhe 550cm për lëvizje dykahore;
 - 1.6.Vendparkimi i rrethuar – 270 cm X 550 cm;
 - 1.7.Vendet për parkim shënohen me vija në gjerësi prej 10cm. Vendet e veçanta të parkimit (për invalidë, vende të rezervuara etj.) shënohen me ngjyrë të verdhë.

IV. MËNYRA E PAGESËS

Neni 8

1. PAGESA e parkimit do të kryhej me shitjen automatike të biletave të parkimit përmes telefonave mobilë, shitjen e biletave të parashtypura të parkimit nëpër qoshqe (kioska) apo edhe përmes shitjes elektronike dhe potencialisht përmes automatëve të parkimit.
2. Biletën e parkimit shfrytëzuesi i vendparkimit duhet ta vendosë në pjesën e poshtme të xhamit të përparmë (erembrojtesin), në mënyrë që kontrollori të mund ta kryejë kontrollimin e vlefshmërisë së biletës. Tek blerja e biletës përmes telefonit mobil, kontrollori kryen verifikimin e pagesës në pajisjen për kontrollim të parkimit.

Neni 9

SHITJA E BILETAVE TË PARKIMIT PËRMES AUTOMATËVE TË PARKIMIT

1. Kjo mënyrë e shitjes së biletave mundëson që në zonën e pagesës së parkimit, të vendosen automatet e parkimit, të cilët e mundësojnë blerjen e lehtë dhe të shpejtë të biletës së parkimit për zonën në të cilën gjendet aparati i parkimit. Në versionin e saj themelor, bileta e parkimit nga automati përmban të dhënat themelore, siç janë: emërtimi i rrugës, zona, numri i automatit dhe i biletës, data, koha e fillimit të parkimit dhe koha deri kur vlen bileta e parkimit.
2. Në çdo automat të parkimit gjenden udhëzimet për shfrytëzimin e automateve të parkimit, ne të cilët tregohet koha dhe çmimi i parkimit, emri i rrugës, numri i zonës së automatit. Automatët bashkëkohorë të parkimit mundësojnë blerjen e biletave të parkimit përmes monedhave, kartëmonedhave, kartelave kreditore.

Neni 10

SHITJA E BILETAVE TË PARKIMIT PËRMES TELEFONAVE MOBILË

1. Pagesa e parkimit është mundësuar me dërgimin e SMS-së, porosisë në numrat e veçantë, të cilët e tregojnë zonën e veçantë të parkimit, derisa për kontrollimin e parkimit shfrytëzohen kompjuterët portativë të dorës me modeme të kohës.
2. Shfrytëzuesi i vendparkimit ka mundësi që përmes telefonit mobil të secilës kompani telefonike që funksionon në Kosovë (nuk ka regjistrim shtesë për shërbim të këtij shërbimi), ta kryejë pagesën, përderisa të huajt të cilët shfrytëzojnë kompanitë telefonike të huaja, nuk iu mundësohet pagesa për shkak të masave rregulluese. Shpenzimet e bëra gjatë pagesës së parkimit përmes telefonit mobil i llogariten shfrytëzuesit nga ana e operatorit telefonik një herë në muaj (për shfrytëzuesit post-paid) dhe menjëherë (për shfrytëzuesit pre-paid).
3. Shfrytëzuesi i parkimit është i obliguar që në biletën e parkimit qartë ta shënojë kohën kur ka filluar parkimi dhe zonën në të cilën shfrytëzon vendparkimin.

Neni 11

SHITJA E BILETAVE TË PARKIMIT PËRMES INTERNETIT

1. Shitja dhe lëshimi i biletave elektronike të parkimit përmes internetit (orëshe, ditore dhe biletave të tjera të parkimit). Shërbimi zhvillohet përmes platformës së internetit, e cila mundëson lidhjen në sistemin e pagesës dhe kontrollimit të parkimit. Për shfrytëzimin e shërbimit është i nevojshëm regjistrimi i shfrytëzuesit.
2. Bazuar në të dhënat e marra nga serveri qendror, operatori i parkingut ka mundësi që të lëshojë faturën për të gjitha pagesat të cilat i ka kryer përmes këtij shërbimi, nëse vetë pala nuk ka pasur mundësi për ta shtypur faturën.

Neni 12

SHITJA E BILETAVE TË PARKIMIT PËRMES APLIKACIONIT NË SMARTPHONE (TELEFON TË MENÇUR)

1. Shitja e biletave të parkimit përmes aplikacionit në smartphone (telefon të mençur), mundësohet përmes instalimit të aplikacionit në pajisjet smartphone dhe përmes regjistrimit me kredit-kartelë. Me aplikacion është e mundur pagesa dhe blerja e llojeve të ndryshme të biletave elektronike të parkimit, siç janë: orëshe, ditore, javore, turistike, komerciale.
2. Bazuar në të dhënat e marra nga serveri qendror, operatori i parkingut ka mundësi që të lëshojë faturën për të gjitha pagesat të cilat i ka kryer përmes këtij shërbimi.

V. LLOJET E BILETAVE TË PARKIMIT

Neni 13

BILETAT E RREGULLTA TË PARKIMIT – ORËSHE DHE DITORE

Propozimin e çmimit për shfrytëzim të vendparkimit, si dhe kohëzgjatjen e atij shfrytëzimi, duhet ta përmbledhim për periudhën kohore gjatë ditës. Për këtë arsye, propozohet periudha kohore në të cilën është vendosur regjimi i propozuar i shfrytëzimit gjatë ditës. Prandaj, për 2 orët e para do të paguhej çmimi i biletës orëshe, ndërsa vazhdimi i parkimit do të ishte karakterizuar si parkim gjatë gjithë ditës, dhe në këtë rast do të shitej bileta ditore e parkimit.

Neni 14

BILETAT MUJORE DHE VJETORE TË PARKIMIT

1. Banorëve rezidentë do t'u ofrohej mundësia e parkimit të privilegjuar në kapacitetet publike të parkimit, (d.m.th. në ato lokacione në të cilat është i paraparë parkimi i privilegjuar) me pagesë minimale.
2. Për këtë qëllim duhet të kryhet procedura e nevojshme administrative (dëshmia e adresës së banimit), dhe të paguhet tarifat administrative dhe shpenzimet material të lëshimit të biletës së parkimit të privilegjuar, për një periudhë të caktuar nga një apo më shumë muaj, derisa vetë ta ndërpresë atë.
3. Shfrytëzimi i privilegjuar i vendparkimeve u referohet tri kategorive të shfrytëzuesve dhe me prioritet, sipas renditjes në vijim:
 - 3.1. Banorët të cilët jetojnë në rrugën ku parkimi paguhet (rezident);
 - 3.2. Personat juridikë të cilët e kanë selinë e vetë në rrugën ku parkimi paguhet, vetëm për veturat e tyre zyrtare;

Për ata do të lëshohet “BILETA ELEKTRONIKE E PARKIMIT TË PRIVILEGJUAR” (e BPP) me të cilën pronari (shfrytëzuesi) i veturës do të identifikohet, dhe në bazë të së cilës do të mund ta shfrytëzonte cilindo vendparkim në lokacionin e caktuar, pa kufizim kohor.

4. “e-BPP” lëshohet në arkë në version elektronik, dhe nuk ka nevojë që e njëjta të shtypet, që do të thotë se i zvogëlon shpenzimet dhe e largon mundësinë e falsifikimit të së njëjtës.
5. Bileta e privilegjuar për këto tri kategori të shfrytëzuesve, nuk nënkupton rezervimin e ndonjë vendi të caktuar të parkimit, pra vetëm mundësinë e shfrytëzimit të vendparkimit në kushtet e privileguara.

Neni 15

BILETAT PARAPAGUESE TË PARKIMIT

1. Përveç biletave të privileguara të parkimit, do të mundësohet edhe blerja e biletave parapaguese për qytetarët e tjerë. Me këtë lloj të biletave të parkimit do të provohej që të motivohen qytetarët, të cilët nuk kanë të drejtë ta kenë biletën e parkimit të privilegjuar, që me blerjen e biletës së parkimit të parapaguar t’i ikin rrezikut e dënimit kontraktual.

Neni 16

MËNYRA E PAGESËS SË ÇMIMIT PËR PARKIM

1. Për shfrytëzimin e parkingut, shfrytëzuesi është i obliguar të paguajë çmimin e parkimit, varësisht nga koha e shfrytëzimit të vendparkimit dhe zonës në të cilën gjendet vendparkimi;
2. Çmimi propozohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, me miratim nga Kuvendi i Komunës;
3. Shfrytëzuesi është i obliguar të paguajë çmimin e parkimit për çdo orë të filluar të shfrytëzimit;
4. Shfrytëzuesi është i obliguar të respektojë kohën e lejuar për parkim.

VI. SHFRYTËZIMI I PARKINGJEVE

Neni 17

1. Përdoruesi i parkingut brenda kuptimit të dispozitave të kësaj rregulloreje, konsiderohet vozitësi ose pronari i një automjeti, nëse vozitësi nuk identifikohet, i cili ka parkuar automjetin në parking.
2. Pagesa e parkimit në zonën I bëhet çdo ditë të javës, 24 orë.
3. Pagesa e parkimit në zonën II bëhet çdo ditë, në intervalin kohor prej orës 07:00 deri në orën 21:00. Pagesa nuk bëhet të dielave dhe ditëve të festave publike.
4. Përdoruesi i parkingut është i obliguar që:
 - 4.1. të përdorë vendin e parkimit në përputhje me sinjalizimin e trafikut vertikal dhe horizontal, me të cilin është shënuar vendi i parkimit;

- 4.2. të veprojnë në përputhje me kufizimin e kohës së shfrytëzimit të hapësirave të parkimit të përcaktuara sipas kësaj rregulloreje;
- 4.3. të paguajnë përdorimin e hapësirave të parkimit sipas kohës së mbajtjes, në mënyrën e përcaktuar dhe sipas listës së çmimeve të vlefshme pas kohës së fillimit;
- 4.4. deri në skadimin e kohës së parkimit të paguar dhe në përputhje me këtë rregullore ta largojë automjetin nga parkingu.

VII. NDALESA E PARKIMIT

Neni 18

1. Parkimi dhe ndalimi i automjeteve në kundërshtim me shenjat e trafikut, sinjalizimin horizontal dhe vertikal;
2. Parkimi dhe ndalimi i automjeteve të paregjistruara;
3. Lënia e një automjeti që nuk funksionon, të braktisur ose të dëmtuar;
4. Parkimi dhe ndalimi i automjeteve në hapësirat e parkimit për personat me aftësi të kufizuara, si dhe në vende të rezervuara parkimi, nëse përdoruesi nuk i përket kategorive të përmendura;
5. Parkimi i një automjeti që nuk i përket kategorisë së automjetit për të cilin është planifikuar parkimi;
6. Parkimi i automjetit për kohë më të gjatë se koha e parashikuar për parkim në zonën e dhënë;
7. Nxënja e parkingjeve duke vendosur rrethoja ose pengesa të ngjashme pa pëlqimin e operatorit.

VIII. MBIKËQYRJA

Neni 19

1. Punët në mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e kësaj rregulloreje e kryen Drejtoria e Inspeksionit.

Neni 20

1. Gjatë mbikëqyrjes inspektuese, inspektori është i obliguar dhe kompetent për:
 - 1.1. sinjalizimin e trafikut në parkingje publike dhe private, t'i urdhërojë operatorët që të mënjanojnë mangësitë në afat të caktuar;
 - 1.2. rregullsinë teknike të parkingjeve publike dhe private, të urdhërojë operatorët që t'i mënjanojnë mangësitë në afat të caktuar;

Neni 21

AUTORIZIMET E INSPEKTORIT

1. Inspektori është i autorizuar të urdhërojë shfrytëzuesin e parkingut për largimin e menjëhershëm të automjetit nëse është parkuar në kundërshtim me këtë rregullore;

2. Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse shfrytëzuesi nuk ndodhet në vendngjarje ose kundërshton largimin e automjetit, inspektori do të marrë vendim, me të cilin i urdhërohet largimi i automjetit në afat të caktuar apo merr vendim për lejimin e konfiskimit, duke lajmëruar automjetin special (merimangën);
3. Vendimi nga paragrafi 2 i këtij neni, vendoset në automjet, duke shënuar ditën dhe orën e vendosjes. Me këtë konsiderohet se vendimi është dorëzuar në mënyrë të rregullt;
4. Inspektori është i autorizuar të kontrollojë nëse parkingjet publike dhe private përdoren në harmoni me destinimin e kësaj rregulloreje, dhe të urdhërojë mënjanimin e mangësive në afat të caktuar;
5. Inspektori është i autorizuar të shqiptojë dënim mandator, të bëjë kërkesë për kallëzim për kundërvajtje në rast të mosveprimit sipas vendimit ekzekutiv, si dhe të ndërmarrë masa të tjera të duhura për shfrytëzimin e parkingjeve publike dhe private në harmoni me dispozitat e kësaj rregulloreje.

IX. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 22

1. Për shkeljet e parapara në nenin 18, paragrafët 1 dhe 5, dënohen me gjobë prej 30 €;
2. Për shkeljet e parapara në nenin 18, paragrafët 2,3,7, dënohen me gjobë prej 100 €;
3. Për shkeljet e parapara në nenin 18, paragrafët 4,6, dënohen me gjobë prej 20 €;
4. Nëse personi juridik operon pa leje për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, dënohet me gjobë prej 1000-3000 €;
5. Operatori publik ose privat i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, dënohet me gjobë prej 200 €;
6. Operatorit publik ose privat, i ndaloheq që të kryejë shërbime të riparimit ose shërbime të larjes së automjeteve, apo aktiviteteve të tjera që ndikojnë në funksionimin normal të parkimit, dënohet me gjobë prej 800-1000 €.
7. Për çdo shkelje nga operatori publik apo privat, që është në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, dënohet me gjobë prej 100-500 €, me përjashtim të pikave nga 1-6.
8. Nëse operatori publik apo privat përsërit shkeljet e përshkruara më lart deri në tri herë e më tepër, i revokohet leja.

X. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-011/02-187748/19, më 01.08.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

